



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:245886

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06189396

CT.nr.16/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në procedurën jo kontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë - testamentare, pas vdekjes së trashëgimlënësit M.J. ish nga Prizreni, duke vendosur lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës për shqyrtimin e trashëgimisë, më 20.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

Pas të ndjerit M.J. ish nga Prizreni, i cili ka lindur më 14.02.1958, ndërsa ka vdekur më 05.07.2023, pa lënë testament e as kontratë mbi mbajtjen e përjetshme, shtetas i Republikës së Kosovës, për trashëgimtar pas të ndjerit M.J. në bazë të trashëgimisë e me obligim të kthimit të borxheve eventuale të trashëgimlënësit, deri në lartësinë e vlerës së trashëguar **SHPALLET**:

- **F.J. nga Prizreni** (bashkëshortja e ndjerit) M.J. në 1/1 pjesës, të parcelës nr.03970-1 ZK Prizren, si dhe mjetet monetare që gjenden në pasqyrën e llogaris së Trustit ne vlere prej 9, 169.03 euro sipas faturës së datës 31.10.2023.

DETYROHET trashëgimtarja e shpallur që kësaj gjykate ti paguajnë taksat gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë, në shumën prej **20.00 €uro**, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate është iniciuar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënësit R.J. pasuria e të cilit është përshkruar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata ka bërë njoftimin për inicimin e procedurës së trashëgimisë dhe të njëjtin e ka publikuar në gazetën zyrtare me qëllim të njoftimit të trashëgimtarëve të tjerë që eventualisht nuk janë të përfshirë në dëshminë e vdekjes.

Gjykata gjatë procedurës dhe nga shkresat e lëndës ka vërtetuar se i ndjeri ka pasur banimin e fundit në territorin e kompetencës territoriale të kësaj gjykate, se ka vdekur më 05.07.2023 pa lënë testament e as kontratë mbi mbajtjen e përjetshme, se ka lënë pasurinë e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi dhe se prej trashëgimtarëve të rendit të parë të trashëgimisë ka lënë trashëgimtaren bashkeshoreten F.J.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje të trashëgimisë me datë 20.09.2024, ku trashëgimtarja F.J. ka pranuar shpallet trashëgimtare, në pasurin e lende na bashkëshorti i saj , ndërsa trashëgimtarëve të tjerë nuk ua ka mohuar të drejtën për trashëgim.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e neneve 12,119 dhe 135 të Ligjit për trashëgiminë i Kosovës, si dhe në dispozitat e neneve 125, 128 dhe 162.3 të Ligjit për procedurën jokontestimore, ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
CT.nr.16/2023, më datë 20.09.2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Pasi që palët në seancë njëzëri kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta e ankesës, ky Aktvendim është i plotfuqishëm nga data 20.09.2024.